

# Anketa Tremujore e Forcave të Punës


## Tremujori I - 2020

**Tiranë, më 10 Qershor 2020:** Në tremujorin e parë 2020, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 61,4 %. Gjatë këtij tremujori, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2019, numri i të punësuarve gjithsej u rrit me 1,1 %, ndërkohë krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2019, ky tregues u ul me 1,3 %.

Në tremujorin e parë 2020, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 11,4 %. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0,7 pikë përqindje, ndërkohë krahasuar me tremujorin e katërt 2019, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0,2 pikë përqindje.

Në tremujorin e parë të vitit 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, për popullsinë 15-64 vjeç, është 69,6 %. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 0,6 pikë përqindje më e lartë, ndërkohë krahasuar me tremujorin e mëparshëm ky tregues shënon një ulje prej 0,1 pikë përqindje.

**Fig. 1 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç, Tr. 1/16 - Tr. 1/20**



Për gratë, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 61,9 %, ndërsa për burrat ky tregues është 77,6 %. Për burrat, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 15,7 pikë përqindje më e lartë sesa për gratë. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2019, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për gratë është rritur me 1,1 pikë përqindje dhe për burrat është rritur me 0,4 pikë përqindje.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 53,4 %. Për popullsinë 30-64 vjeç, në tremujorin e parë 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 78,0 %.


**Punësimi**

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 61,4 %.

Ritmi vjetor i rritjes së punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, nga tremujori i parë i vitit 2019 në tremujorin e parë të vitit 2020, është 1,1 %. Në terma vjetorë, rritja e punësimit sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë është 4,2 % në sektorin e industrisë, 1,1 % në sektorin e shërbimeve ndërsa sektori i bujqësisë shënon ulje me 0,5 %.


Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, në tremujorin e parë 2020, punësimi për popullsinë 15 vjeç e lart u ul me 1,3 %. Punësimi pësoi ulje në sektorin e bujqësisë 2,8 %, në sektorin e industrisë me 0,9 % dhe në sektorin e shërbimeve me 0,3 %.

**Fig. 2 Ndryshimi vjetor dhe tremujor i punësimit, për popullsinë 15 vjeç e lart (%)**



Shkalla e punësimit për burrat është 68,7 %, ndërsa për gratë 54,2 %. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2019, shkalla e punësimit për burrat është rritur me 1,3 pikë përqindje dhe për gratë me 0,9 pikë përqindje. Shkalla e punësimit të të rinjve është 42,7 %. Për popullsinë 30-64 vjeç, në tremujorin e parë 2020, shkalla e punësimit është 70,9 %.

**Fig. 3 Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç, Tr. 1/16 - Tr. 1/20**




**Papunësia**

Në tremujorin e parë 2020, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 11,4 %. Në terma vjetorë, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0,7 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0,2 pikë përqindje.

Shkalla zyrtare e papunësisë për burrat është 11,0 % dhe për gratë 11,9 %. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2019, shkalla e papunësisë për burrat ka rënë me 1,2 pikë përqindje, ndërsa për gratë ka mbetur në të njëjtin nivel.

**Fig. 4 Shkalla e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, Tr. 1/16 - Tr. 1/20**



Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë është 20,0 %. Në terma vjetorë shkalla e papunësisë së të rinjve shfaq tendencë në rënie. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019, shkalla e papunësisë për të rinjtë në tremujorin e parë të vitit 2020 është 2,2 pikë përqindje më e ulët. Krahasuar me tremujorin e katërt 2019, shkalla e papunësisë për të rinjtë është ulur me 1,4 pikë përqindje.


Shkalla e papunësisë për grup-moshën 30-64 vjeç është 9,1 %. Në terma vjetorë ky tregues ka mbetur në të njëjtin nivel. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm për këtë grup-moshë shkalla e papunësisë u rrit me 0,8 pikë përqindje.

**Popullsia ekonomisht jo-aktive**

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, 18,5 % e popullsisë ekonomisht jo-aktive dhe në moshë pune (15-64 vjeç) ishin duke përmbushur detyrat shtëpiake, 11,7 % e saj ishte në pension ose pension të parakohshëm, ndërsa 11,5 % në paaftësi të përhershme.

Gjatë tremujorit të parë 2020, 11,0 % e popullsisë ekonomisht jo-aktive (në grup-moshën 15-64 vjeç) deklaruan se nuk po kërkonin punë pasi besonin se nuk ka punë të disponueshme, pra klasifikohen si të papunë të dekurajuar.

**Fig. 5 Struktura e popullsisë ekonomisht jo-aktive sipas gjinisë dhe statusit**



Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që deklaruan se janë nxënës/studentë ose në trajnim përbëjnë 71,2 % të të rinjve ekonomisht jo-aktivë. Ndër të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ekonomisht jo-aktivë, 8,6 % klasifikohen si të papunë të dekurajuar. Në popullsinë e moshës 30-64 vjeç ky grup përbën 13,7 % të popullsisë ekonomisht jo-aktive të kësaj grup-moshe.

**Tab. 1 Shkalla e papunësisë Tr.1/16 - Tr.1/20**

Moshë	Gjinia	Tr.1.2016	Tr.2.2016	Tr.3.2016	Tr.4.2016	Tr.1.2017	Tr.2.2017	Tr.3.2017	Tr.4.2017	Tr.1.2018	Tr.2.2018	Tr.3.2018	Tr.4.2018	Tr.1.2019	Tr.2.2019	Tr.3.2019	Tr.4.2019	Tr.1.2020
		15 vjeç e lart	Totali	16,6	15,5	14,7	14,2	14,2	13,9	13,6	13,4	12,5	12,4	12,2	12,3	12,1	11,5	11,4
	Meshkuj	17,4	16,4	15,3	14,5	15,6	14,9	14,3	13,7	12,6	12,9	12,6	12,5	12,2	11,6	11,4	11,3	11,0
	Femra	15,5	14,2	14,0	13,7	12,2	12,5	12,6	12,9	12,3	11,8	11,7	11,9	11,9	11,4	11,4	11,0	11,9
15-64 vjeç	Total	16,9	15,9	15,2	14,5	14,6	14,3	14,0	13,6	13,0	12,9	12,7	12,7	12,6	12,0	11,8	11,6	11,9
	Meshkuj	17,8	17,0	15,9	15,0	16,1	15,4	14,8	14,1	13,2	13,5	13,1	13,0	12,8	12,1	11,9	11,8	11,5
	Femra	15,8	14,5	14,3	13,9	12,5	12,8	12,8	13,0	12,7	12,2	12,1	12,3	12,3	11,8	11,8	11,4	12,4
15-29 vjeç	Total	30,4	29,9	27,4	28,1	26,6	26,4	26,0	24,6	24,5	22,6	23,2	22,3	22,2	20,9	21,4	21,4	20,0
	Meshkuj	30,7	31,2	27,7	29,3	28,6	27,4	26,6	25,6	24,2	23,4	22,8	22,4	22,4	21,0	20,6	21,2	19,9
	Femra	30,1	28,0	26,9	26,2	23,4	24,7	25,0	23,1	24,9	21,5	23,8	22,2	21,9	20,8	22,4	21,5	20,2
30-64 vjeç	Total	12,9	11,9	11,7	10,6	11,2	10,8	10,6	10,5	9,2	9,6	8,9	9,2	9,1	8,8	8,5	8,3	9,1
	Meshkuj	13,5	12,6	12,1	10,5	12,3	11,5	11,1	10,6	9,3	9,7	9,2	9,4	9,1	8,8	8,8	8,5	8,4
	Femra	12,2	11,0	11,1	10,7	9,8	9,9	10,0	10,4	9,0	9,5	8,5	8,9	9,1	8,8	8,1	7,9	9,8

**Tab. 2 Shkalla e punësimit Tr.1/16 - Tr.1/20**

Moshë	Gjinia	Tr.1.2016	Tr.2.2016	Tr.3.2016	Tr.4.2016	Tr.1.2017	Tr.2.2017	Tr.3.2017	Tr.4.2017	Tr.1.2018	Tr.2.2018	Tr.3.2018	Tr.4.2018	Tr.1.2019	Tr.2.2019	Tr.3.2019	Tr.4.2019	Tr.1.2020
		15 vjeç e lart	Totali	47,5	48,4	49,9	49,1	49,2	50,0	50,7	51,2	51,9	52,0	52,2	52,3	52,5	53,6	53,8
	Meshkuj	53,1	54,0	56,1	55,4	55,6	56,7	57,7	58,2	58,9	58,7	59,4	59,0	59,2	60,3	60,4	60,4	60,0
	Femra	41,9	42,8	43,7	42,8	42,7	43,4	43,8	44,2	45,0	45,4	45,0	45,7	45,9	47,1	47,3	47,4	46,5
15-64 vjeç	Total	54,8	55,3	57,1	56,2	56,3	57,3	57,7	58,2	59,2	59,2	59,7	60,0	60,3	61,4	61,5	61,6	61,4
	Meshkuj	60,4	61,1	63,4	62,8	62,9	64,1	64,7	65,6	66,5	66,3	67,3	66,9	67,4	68,4	68,5	68,5	68,7
	Femra	49,0	49,6	50,8	49,6	49,5	50,3	50,5	50,8	51,9	52,2	52,1	53,1	53,3	54,6	54,7	54,8	54,2
15-29 vjeç	Total	32,1	31,6	33,5	32,5	33,0	33,6	33,5	34,9	35,9	37,9	39,5	40,8	41,0	41,9	41,3	40,6	42,7
	Meshkuj	36,5	34,8	37,9	35,9	36,9	38,4	39,2	39,7	41,6	44,5	46,8	46,0	46,7	47,3	46,9	45,5	48,3
	Femra	27,0	28,0	28,4	28,6	28,4	28,1	26,9	29,7	29,8	31,1	31,8	35,1	35,1	36,3	35,7	35,8	37,2
30-64 vjeç	Total	65,7	66,8	68,5	67,8	67,5	68,6	69,3	69,4	71,9	70,8	70,7	70,5	70,6	71,8	72,3	72,7	70,9
	Meshkuj	73,0	74,8	76,7	77,0	76,6	77,8	78,1	79,0	80,6	78,6	79,1	78,8	78,8	80,0	79,9	80,9	79,5
	Femra	58,6	59,2	60,6	58,9	58,7	60,0	60,9	60,3	63,5	63,3	62,6	62,4	62,6	63,9	64,8	64,8	62,8

**Tab. 3 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës Tr.1/16 - Tr.1/20**

Moshë	Gjinia	Tr.1.2016	Tr.2.2016	Tr.3.2016	Tr.4.2016	Tr.1.2017	Tr.2.2017	Tr.3.2017	Tr.4.2017	Tr.1.2018	Tr.2.2018	Tr.3.2018	Tr.4.2018	Tr.1.2019	Tr.2.2019	Tr.3.2019	Tr.4.2019	Tr.1.2020
		15 vjeç e lart	Totali	56,9	57,2	58,5	57,2	57,3	58,1	58,7	59,1	59,3	59,3	59,4	59,6	59,7	60,6	60,7
	Meshkuj	64,3	64,7	66,3	64,8	66,0	66,6	67,3	67,4	67,4	67,4	68,0	67,5	67,5	68,2	68,2	68,1	67,4
	Femra	49,5	49,9	50,8	49,5	48,6	49,6	50,1	50,8	51,3	51,4	51,0	51,9	52,1	53,1	53,4	53,3	52,8
15-64 vjeç	Total	65,9	65,8	67,3	65,7	65,9	66,8	67,1	67,4	68,0	68,0	68,3	68,7	69,0	69,8	69,8	69,7	69,6
	Meshkuj	73,4	73,5	75,3	73,8	75,0	75,7	76,0	76,4	76,6	76,6	77,4	76,9	77,2	77,8	77,7	77,7	77,6
	Femra	58,2	58,1	59,2	57,6	56,6	57,7	58,0	58,4	59,5	59,5	59,3	60,6	60,8	61,9	62,0	61,9	61,9
15-29 vjeç	Total	46,2	45,0	46,1	45,2	44,9	45,7	45,2	46,3	47,5	49,0	51,4	52,5	52,7	53,0	52,5	51,7	53,4
	Meshkuj	52,7	50,6	52,5	50,8	51,6	52,9	53,4	53,3	54,9	58,1	60,5	59,3	60,2	59,9	59,1	57,8	60,2
	Femra	38,6	38,9	38,8	38,8	37,1	37,3	35,9	38,6	39,7	39,6	41,7	45,1	45,0	45,8	46,0	45,6	46,6
30-64 vjeç	Total	75,4	75,8	77,5	75,8	76,0	76,9	77,5	77,6	79,1	78,3	77,5	77,6	77,6	78,7	79,0	79,2	78,0
	Meshkuj	84,4	85,6	87,3	86,0	87,3	87,9	87,8	88,3	88,9	87,1	87,1	87,0	86,7	87,8	87,6	88,4	86,8
	Femra	66,7	66,5	68,1	66,0	65,1	66,6	67,7	67,3	69,8	69,9	68,4	68,5	68,9	70,0	70,5	70,4	69,6

# Metodologjia

Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) është një vrojtim statistikor që kryhet pranë familjeve. Objektivi kryesor i saj është të japë informacion mbi situatën e tregut të punës në Shqipëri i cili përdoret për të hartuar politikat e tregut të punës dhe për vlerësimin e efektshmërisë së tyre, si dhe për të kënaqur nevojat e përdoruesve të statistikave për të dhëna të përditësuara mbi dinamikën e tregut të punës.

Baza e zgjedhjes e përdorur për ATFP bazohet në të dhënat përmbledhëse për zonat e numërimit sipas Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011. Madhësia e zgjedhjes për ATFP për tremujorin e parë të vitit 2020 është 7.935 familje. Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure me dy hapa, ku në hapin e parë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit, dhe në hapin e dytë, brenda secilës prej këtyre zonave gjeografike zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks familjesh.

Për ATFP përdoret një strukturë panel e alternuar zgjedhjeje, përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në kampion për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Intervistat për të njëjtën familje janë planifikuar të kryhen saktësisht pas 13 javëve, kështu intervista e pestë kryhet një vit më pas intervistës së parë. Në tremujorin e parë të vitit 2020, shkalla e përgjigjes së familjeve ishte 79,1 %.

Në tremujorin e parë (Janar – Mars) 2020, me marrjen e masave të veçanta për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, INSTAT ka ndërprerë intervistat direkte në familje. Anketa e Forcave të Punës, për t'ju përgjigjur situatës së krijuar dhe për të siguruar mbledhjen e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e treguesve të punësimit, është kryer nëpërmjet intervistave telefonike për periudhën e referencës nga data 9 – 29 Mars 2020. Intervistat telefonike nuk ka qënë e mundur të realizohen për ato familje që ishin të reja në kampion dhe për të cilat intervistimi duhej të kryhej në datat e mësipërme sipas kalendarit të anketës. Gjithashtu, edhe për familjet ekzistuese në kampion, jo të gjitha intervistat kanë qënë të mundura dhe si rrjedhim shkalla e përgjigjes në periudhën në fjalë ka qënë më e ulët se në javët paraardhëse të tremujorit.

Mbledhja e të dhënave në terren bëhet përgjatë gjithë muajve të vitit. Në familjet e zgjedhura anketohen nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë të gjithë pjesëtarët në moshë 15 vjeç e lart. Pyetësi i ATFP është hartuar me asistencën teknike të EUROSTAT dhe ai është në përputhje të plotë me rekomandimet dhe rregulloret e EUROSTAT. Nga ana metodologjike anketa plotëson kërkesat e EUROSTAT-it si ato që lidhen me përfaqësimin e kampionit, koeficientet e variacionit të treguesve kryesorë, përmbajtjen e pyetësorit, si dhe me procedurat e peshimit të të dhënave.

Për procedurën e përgjithësimin të të dhënave të Anketës së Forcave të Punës përdoret popullsia e llogaritur mbi bazën e rezultateve të Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011 dhe ngjarjeve demografike (lindjet dhe vdekjet) që vijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

**Popullsia në moshë pune** është popullsia 15-64 vjeç.

**Të punësuar** janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. **Java e referencës** është java kalendarike nga e hëna në të diel para datës së intervistës.

Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës, si dhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkohshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor stinor ose (b) personi merr 50 për qind ose më shumë të pagës; (3) të vetë-punësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetë-konsum, janë konsideruar të punësuar.

**Të papunë** konsiderohen personat që ishin:

- a) pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi;
- b) aktualisht të gatshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës);
- c) duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të vetin) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifike për të kërkuar punë konsiderohen:

- kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë
- kontakt me një agjenci private punësimi për të gjetur punë
- aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi
- kërkuar miqve/shokëve, të afërmeve, sindikatave etj,
- vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta
- studiuar lajmërimet në gazeta
- marrë pjesë në një test apo intervistë
- kërkuar për tokë, godinë ose pajisje
- aplikuar për leje, licenca ose burime financiare

**Forca e Punës** përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

**Popullsia jo-ekonomikisht aktive** përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (pra, nxënës/studentë, shtëpiakë, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

**Shkalla e punësimit** është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.



**Shkalla e papunësisë** është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

**Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës** është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.

## Notë shpjeguese mbi treguesit kryesorë të tregut të punës

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkalla punësimit llogariten për popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomikisht aktive (ndryshe forca e punës) të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës të llogaritura mbi popullsinë 15 vjeç e lart ndikohen nga përfshirja e personave në pension në emërues dhe kështu janë më pak kuptimplotë sesa shkallët e llogaritura për popullsinë e moshës 15-64 vjeç. Ndërsa, në llogaritjen e shkallës së papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, në emërues kemi popullsinë ekonomikisht aktive, e cila përfshin personat e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune dhe të aftë për punë, dhe si rrjedhojë ky tregues nuk ndikohet nga popullsia mbi moshën e pensionit.

## Cilësia e statistikave të tregut të punës

Treguesit kryesorë të tregut të punës vlerësohen nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës. Anketa është bazuar në një zgjedhje probabilitare prej 7.935 njësisish ekonomike familjare. Zgjedhja e njësisive ekonomike familjare është bërë e tillë që të sigurojë vlerësime sa më të sakta për treguesit kryesorë të tregut të punës. Pra, nga anketa mund të sigurohen vlerësime dhe jo shifra ekzakte për numrin e të punësuarve dhe të papunëve. Për çdo vlerësim që merret nga anketa llogaritet varianca e zgjedhjes për të parë se si do të ndryshonte vlerësimi nëse do të kryheshin zgjedhje të ndryshme të rastit me të njëjtin vëllim për të njëjtën periudhë, në vend të një zgjedhjeje të vetme. Kjo na lejon që të përcaktojmë kufijtë brenda të cilëve duhet të gjendet vlerësimi (që në terminologjinë statistikore njihet si intervali i besimit).

Në përgjithësi, sa më e vogël të jetë vlera e devijimit standard relativ të një vlerësimi aq më i lartë është niveli i saktësisë së vlerësimit. Në tabelën 4 paraqiten devijimi standard relativ dhe intervali i besimit për treguesit kryesorë të tregut të punës për popullsinë 15 vjeç e lart.

**Tab. 4 Devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes për treguesit kryesorë të tregut të punës**

	Numri i të punësuarve Grup-mosha: 15+	Shkalla e punësimit në përqindje ndaj popullsisë Grup-mosha: 15+	Numri i të papunëve Grup-mosha: 15+	Shkalla e papunësisë si një përqindje ndaj forcave të punës Grup-mosha: 15+
<b>VLERESIMI</b>	1258057	53.2	162041	11.4
<b>CV (Koeficienti i variacionit)</b>	1.22	1.22	6.04	6.0
<b>SE (Devijimi standart)</b>	15366	0.65	9795	0.68
<b>CI * (Intervali i besimit)</b>	(1227940-1288174)	(51.88-54.42)	(142843-181240)	(10.08-12.74)

(\*) për nivelin e besueshmërisë 95 %

Shkalla e papunësisë për nivelin e besueshmërisë 95 % gjendet mes vlerave 10,08 % dhe 12,74 % dhe ka një devijim standard 0,68 %. Devijimi standard për përpjesën e popullsisë 15+ vjeç në punësim është 0,65 % dhe për nivelin e besueshmërisë 95 % vlerësimi për shkallën e punësimit gjendet mes vlerave 51,88 % dhe 54,42 %.